



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 25/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.01.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kreatx” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-80571-12-01-2020, me objekt “*Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive*”, me fond limit 1.666.667 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.”

Ankimues: “Kreatx” sh.p.k.
Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Sami Frashëri”, Nr.39, Kati i dytë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër
Rruga “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për*

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik, pa i hyrë vlerësimit të çështjes *ratione materiae*, vlerëson të ndalet tek respektimi i kërkesave formale (afateve) të ankimimit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.12.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. *REF-80571-12-01-2020*, me objekt “*Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive*”, me fond limit 1.666.667 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

II.2. Në datën 14.12.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 22.12.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|------------------------------|
| 1. “Kreatx” sh.p.k. | 1.415.000 lekë, skualifikuar |
| 2. “Delia Impex” sh.p.k. | 1.566.630 lekë, skualifikuar |
| 3. “Infosoft Software Developer” sh.p.k. | 1.620.000 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 22.12.2020 operatori ekonomik “Kreatx” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” sh.p.k., ky i fundit pretendon se në datën 28.12.2020, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Ndërkohë që, referuar aktit të trajtimit të ankesës, konstatohet që kjo e fundit është protokolluar pranë autoritetit kontraktor datë 30.12.2020. Operatori ekonomik ankimues, nuk ka paraqitur asnjë provë apo fakt për të dokumentuar se ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor në datë 28.12.2020, por vetë operatori ekonomik ankimues në ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik deklaroi se *“në datë 28.12.2020, i cili e ka administruar në datë 30.12.2020, kemi paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër”*.

II.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se autoriteti kontraktor me anë të shkresës me nr.19803/1 prot, datë 07.01.2021, me objekt *“Kthim përgjigje”*, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Kreatx” sh.p.k., duke e refuzuar atë.

Ndërkohë operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë KPP, pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthim përgjigjen nga autoriteti kontraktor, në datë 11.01.2021.

II.7. Në datën 13.01.2021, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, si dhe dokumentacionit bashkëngjitur,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Kreatx” sh.p.k. se arsyet e skualifikimit të ofertës së tij të dhëna nga autoriteti kontraktor nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet në arsyetimin, përse i përket respektimit të kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Në lidhje me afatet, pas shqyrtimit të ankesës, rezultoi si më poshtë:

III.1.1. Në datën 02.12.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-80571-12-01-2020, me objekt “Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive”, me fond limit 1.666.667 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

III.1.2. Në datën 14.12.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 22.12.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|------------------------------|
| 1. “Kreatx” sh.p.k. | 1.415.000 lekë, skualifikuar |
| 2. “Delia Impex” sh.p.k. | 1.566.630 lekë, skualifikuar |
| 3. “Infosoft Software Developer” sh.p.k. | 1.620.000 lekë, skualifikuar |

III.1.4. Në datën 22.12.2020 operatori ekonomik “Kreatx” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

III.1.5. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Kreatx” sh.p.k., ky i fundit pretendon se në datën 28.12.2020, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Ndërkohë që, referuar aktit të trajtimit të ankesës, konstatohet që kjo e fundit është protokolluar pranë autoritetit kontraktor datë 30.12.2020. Operatori ekonomik ankimes, nuk ka paraqitur asnjë provë apo fakt për të dokumentuar se ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor në datë 28.12.2020, por vetë operatori ekonomik ankimes në ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik deklaron se *“në datë 28.12.2020, i cili e ka administruar në datë 30.12.2020, kemi paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër”*.

III.1.6. Referuar informacionit dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimes, konstatohet se autoriteti kontraktor me anë të shkresës me nr.19803/1 prot, datë 07.01.2021, me objekt *“Kthim përgjigje”*, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Kreatx” sh.p.k., duke e refuzuar atë. Ndërkohë operatori ekonomik ankimes në ankesën e paraqitur pranë KPP, pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthim përgjigjen nga autoriteti kontraktor, në datë 11.01.2021.

III.1.7. Në datën 13.01.2021, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr. 9643, dt.20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

1. *Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*

1.1 *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj*

vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues të dorëzuar pranë institucionit tonë, ky i fundit pretendon se ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në datën 28.12.2020, por autoriteti kontraktor e ka administruar ankesën e tij në datë 30.12.2020. Gjithashtu, referuar aktit të trajtimit të ankesës, konstatohet se kjo e fundit është protokolluar pranë autoritetit kontraktor datë 30.12.2020.

Referuar ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor i paraqitet së pari me shkrim këtij të fundit brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor nis ditën e nesërme të punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, të parashikuar në nenin 63 pika 2 të LPP-së.

Në rastin konkret, Komsioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së, pra nuk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor brenda afateve që parashikon legjislacioni për prokurimin publik.

III.1.10. Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues bashkëngjitur ankesës së depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është paraqitur dhe formulari i ankesës të cilin operatori ekonomik ankimues pretendon se e ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor në datën 28.12.2020, por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion tjetër provues më anë të të cilit të vërtetojë se ankesa është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në këtë datë. Akoma më tej, vetë operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik deklaroi se “në datë 28.12.2020, i cili e ka administruar në datë 30.12.2020, kemi paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër”.

III.1.11. Referuar lex specialis, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor dorëzohet me shkrim brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës, kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte

vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor nis ditën e nesërme të punës pas marrjes dijeni për shkeljen e pretenduar.

Sa më sipër, KPP gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar si edhe parashtrimeve para Komisionit të Prokurimit Publik, ankimuesi vetëm parashtron pretendime që si datë e dorëzimit të ankesës të pranohet data 28.12.2020, pa e shoqëruar me prova dhe fakte, ndërkohë që referuar aktit administrativ nr.19803/1 prot., date 07.01.2021, trajtim i ankesës nga autoriteti kontraktor, vërtetohet që ankesa e operatorit ekonomik ankimues është protokolluar pranë autoritetit kontraktor në datën 30.12.2020.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk mjafton vetëm pohimi i operatorit ekonomik ankimues për të vërtetuar datën e paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor, por operatori ekonomik duhet të paraqiste prova dhe fakte për të vërtetuar datën e dorëzimit të ankesës së tij.

III.1.12. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “Kreatx” sh.p.k., nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.13. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-80571-12-01-2020, me objekt “*Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive*”, me fond limit 1.666.667 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 14.12.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 62 Protokolli

Datë 13.01.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri